

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-100/11

Prishtinë, 8 mars 2012

Në çështjen civile të:

V.A.G.

Paraqitësi i kërkesës/Pala ankuese

Kundër

N.F.

Pala përgjegjëse në kërkesë/Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, Elka Ermenkova dhe Sylejman Nuredini, Gjyqtarë, në lidhje me ankesën ndaj vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KKPK/D/A/102/2011 (lënda është e regjistruar në AKP me numrat KPA16011, KPA16012, KPA16013, KPA16014, KPA90427, KPA90428, KPA90429, KPA90432, KPA90433, KPA90435 dhe KPA90436), të datës 23 shkurt 2011, pas shqyrtimit të mbajtur me 8 mars 2012, mori këtë:

AKTGJYKIM

- 1- Refuzohet si e pabazuar ankesa e V.A.G..
- 2- Konfirmohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KKPK/D/A/102/2011, i datës 23 shkurt 2011, për sa i përket lëndëve me numrat KPA16011, KPA16012, KPA16013, KPA16014, KPA90427, KPA90428, KPA90429, KPA90432, KPA90433, KPA90435 dhe KPA90436.
- 3- Obligohet pala ankuese që t'i paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej € 350 (treqind e pesëdhjetë) brenda afatit prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

Me 25 gusht 2006, V.A.G., duke shfrytëzuar katër formularë të kërkesave, ka paraqitur disa kërkesa në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), ku kërkonte që të njëjët si pronar i ngastrave të ndryshme të tokës të fituara me anë të trashëgimisë dhe ka kërkuar ri-posedimin e tyre. Ai ka shpjeguar se këto ngastra i përkisnin nënës së tij të ndjerë, S.I.G., dhe se pas vdekjes së saj ai i kishte trashëguar ato. Në dy nga formularët e kërkesës të nënshkruar nga paraqitësi i kërkesës lidhur me kërkesat GSK-KPA-A-102/11, GSK-KPA-A-103/11, GSK-KPA-A-104/11, GSK-KPA-A-105/11, GSK-KPA-A-106/11, ndër të tjera thuhet si në vijim: “Më nënshkrimin e këtij formulari, paraqitësi i kërkesës vërteton se e drejta e tij/saj pronësore ndërlidhet me pronën e paluajtshme private që është humbur si rezultat i rrethanave në vitin 98/99 në Kosovë dhe deklaroi se data e humbjes është 01/01/1999”. Megjithatë, në dy formularët tjerë të kërkesave lidhur me lëndët GSK-KPA-A-100/11, GSK-KPA-A-101/11, GSK-KPA-A-107/11, GSK-KPA-A-108/11, GSK-KPA-A-109/11 dhe GSK-KPA-A-110/11, të cilët po ashtu janë nënshkruar nga paraqitësi i kërkesës, ceket si në vijim: “Më nënshkrimin e këtij formulari, paraqitësi i kërkesës vërteton se e drejta e tij/saj pronësore ndërlidhet me pronën e paluajtshme private që është humbur si rezultat i rrethanave në vitin 98/99 në Kosovë dhe deklaroi se data e humbjes është 01/01/1981”.

Për ta mbështetur kërkesën e tij, ai ka paraqitur në AKP dokumentet si në vijim:

- Certifikatën e vdekjes të lëshuar nga Republika e Serbisë, Komuna e Prokupljes me datën 25 nëntor 1983, e cila tregon se S.G., e gjinisë J., bija e I.J., me adresë të vendbanimit të përhershëm në Prokuplje, Bitoljska 54, kishte vdekur me 19 nëntor 1983 në Prokuplje;
- Fletën poseduese nr. 22, të lëshuar nga Republika e Serbisë, Komuna e Prishtinës, Komuna Kadastrale e Podujevës me 25 nëntor 2002.

Fleta poseduese nr. 22 ka treguar se G.I.S. nga Llausha ishte pronare e ngastrave të kërkuara në Komunën e Podujevës në zonën kadastrale të Llaushës, si në vijim:

Numri i ankesës dhe dosjes së lëndës së AKP-së	Të dhënat lidhur me ngastrën e kërkuar
GSK-KPA-A-100/11 (KPA16011)	Ngastrat nr. 1603(I) dhe 1604, në vendin e quajtur “Via-Ner Shpija” : Ngastra nr. 1603 (I), kullosë e klasës 3 me sipërfaqe prej 1 ari e 12 m ² ; Ngastra nr. 1604, kullose e klasës 3 me sipërfaqe prej 4 ari e 71 m ²
GSK-KPA-A-101/11 (KPA16012)	Ngastra nr. 1605, në vendin e quajtur “Via-Ner Shpija”, arë e klasës 6 me sipërfaqe prej 72 ari e 67 m ²
GSK-KPA-A-102/11 (KPA16013)	Ngastra nr. 1606, në vendin e quajtur “Via-Ner Shpija”, livadh i klasës 5 me sipërfaqe prej 27 ari e 26 m ²
GSK-KPA-A-103/11 (KPA16014)	Ngastra nr. 1603 (II), në vendin e quajtur “Via-Ner Shpija”, Llaushë, mal i klasës 4 me sipërfaqe prej 11 ari 41 m ²
GSK-KPA-A-104/11 (KPA90427)	Ngastra nr. 1633, në vendin e quajtur “Via-Tu Shpija”, livadh i klasës 5 me sipërfaqe prej 7 ari e 12 m ²
GSK-KPA-A-105/11 (KPA90428)	Ngastra nr. 1640, në vendin e quajtur “Via-Lidvadh Mas Sp”, livadh i klasës 5 me sipërfaqe prej 29 arie 88 m ²
GSK-KPA-A-106/11 (KPA90429)	Ngastrat nr. 1616(I) dhe 1617: Ngastra nr. 1616(I), në vendin e quajtur “Via-Oborr”, kullosë e klasës 5 me sipërfaqe prej 5 ari e 93 m ² ;

	Ngastra nr. 1617, në vendin e quajtur “Via-Tu Shpija”, kopsht i klasës 3 me sipërfaqe prej 17 ari e 30 m ²
GSK-KPA-A-107/11 (KPA90432)	Ngastrat nr. 1616(II dhe III) dhe 1619: Ngastra nr. 1616(II), në vendin e quajtur “Via-Oborr”, shtëpi dhe objekte përcjellëse, me sipërfaqe prej 90 m ² ; Ngastra nr. 1616(III), në vendin e quajtur “Via-Oborr”, oborr me sipërfaqe prej 5 ar; Ngastra nr. 1619, në vendin e quajtur “Via-Tu Shpija”, kullosë e klasës 3 me sipërfaqe prej 79 ari e 66 m ²
GSK-KPA-A-108/11 (KPA90433)	Ngastra nr. 1625, në vendin e quajtur “Via-Ner Shpija”, kullosë e klasës 3 me sipërfaqe prej 2 ari e 71 m ²
GSK-KPA-A-109/11 (KPA90435)	Ngastra nr. 1620, në vendin e quajtur “Via-Ara Ner Shpija”, arë e klasës 6 me sipërfaqe prej 1 ha, 0 ari e 27 m ²
GSK-KPA-A-110/11 (KPA90436)	Ngastra nr. 1624, në vendin e quajtur “Via-Ner Shpija”, arë e klasës 4 me sipërfaqe prej 4 ari e 11 m ²

Më vonë gjatë procedurës, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur Certifikatën e tij lindjes.

Fleta poseduese nr. 22, Certifikata e lindjes si dhe Certifikata e vdekjes së bartësit të së drejtës pronësore që ishin paraqitur kanë mundur të verifikohen.

Në vitin 2009 dhe 2010, ekipi i AKP-së për njoftim ka shkuar në vendet ku pretendohet se ndodheshin ngastrat e kërkuara dhe ka vendosur shenjat që tregoni se prona ishte subjekt i kërkesës dhe se palët e interesuara duhet t’i paraqesin përgjigjet e tyre brenda 30 ditëve. E gjithë prona ishte gjetur e uzurpuar nga familja F., anëtarët e së cilës kanë pretenduar të drejtën ligjore ndaj pronës të cilën, siç deklaruan ata, e kishin blerë para rreth 50 viteve. Më vonë gjatë procedurës njoftimi është vërtetuar edhe me anë të GPS-it dhe koordinatave ortofotografike dhe është gjetur të ketë qenë i saktë. Njoftimi është përsëritur nëpërmjet publikimit në gazetë vetëm në lëndën GSK-KPA-A-110/11..

Me 24 qershor 2009, N.F. ka paraqitur një përgjigje në AKP, duke cekur se ai ishte bartësi i së drejtës pronësore. Ai ka shpjeguar se S.G. ia kishte shitur pronës H.S. dhe se R.S. dhe babai i tij U.S. kishin qenë dëshmitarë. Ai ka deklaruar se paratë ishin paguar dhe se pas kësaj familja F. – si blerës të tretë – e kishte

blerë këtë pronë nga H.R.. Ai ka paraqitur deklaratat me shkrim të dy dëshmitarëve, të cilët kanë konfirmuar se toka ishte shitur para 52 viteve, si dhe fletëpagesën lidhur me pagesën e taksave për pronën e paluajshme prej 86 m², të datës 15 mars 2004.

Në letrën e tij të datës 13 janar 2011, lidhur me kërkesat e regjistruara me numrat KPA16011, KPA16014 dhe KPA90428, paraqitësi i kërkesës ka deklaruar se pala përgjegjëse në kërkesë nuk kishte paraqitur prova të valide rreth blerjes së pretenduar të pronave dhe se, nëse shitblerjet ishin bërë në vitin 1957 apo 1958, ato më siguri kanë qenë të regjistruara. Përveç kësaj, ai ka sqaruar: “Shtëpia e prindërve të mi të ndjerë është nga mesi i viteve të pesëdhjeta të shekullit të kaluar. Ajo ka mbetur si shtëpia e fundit në vendin Llaushë e Poshtme afër Podujevës, nga dhjetë familje serbe sa kanë jetuar në këtë fshat pas Luftës së Dytë Botërore. Çdo ditë ne kemi jetuar me frikë nga fqinjët shqiptarë, dhe për këtë arsye familjet tjera serbe është dashur që t’i shesin pronat e tyre dhe janë detyruar që të largohen nga Llausha e Poshtme. Siç e kam cekur me parë, edhe unë jam larguar nga Llausha e Poshtme në vitin 1962 me familjen time ndërsa nëna ime e ndjerë S. kishte mbetur e vetëm në fshat. Nëna ime e ndjerë kishte qenë për çdo ditë nën presione dhe shantazhe nga familja S. për t’ua shitur pronën në fshat. Megjithatë, ajo nuk kishte dashur ta shiste pronën dhe kishte mbetur aty, ndërsa pak para vdekjes së saj ajo kishte ardhur për të jetuar me mua në Prokuplje, ku edhe kishte vdekur në vitin 1983”.

Me 23 shkurt 2011, Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës (KKPK) me vendimin e tij KKPK/D/A/102/2011 i ka hedhë poshtë kërkesat pasi që ato nuk kanë qenë në juridiksion të KKPK-së. Nën nr. 28 vendimin thekson si në vijim: “Fillimisht është pohuar se paraqitësi i kërkesës i kishte humbur pronat si rezultat i konfliktit të vitit 1998-1999, megjithatë paraqitësi i kërkesës më vonë e ka njoftuar Sekretarinë Ekzekutive se familja e tij nuk i ka pasur në posedim pronat e kërkuara që nga viti 1970 e tutje. Ai po ashtu ka konfirmuar se ai as nuk ka qenë në posedim e as nuk i ka shfrytëzuar pronat e kërkuara në kohën e konfliktit në Kosovë në vitin 1998/1999. Në këto rrethana, Komisioni vjen në përfundim se nuk mund të thuhet se humbja e pretenduar e së drejtës pronësore ka pasur lidhje me konfliktin. Rrjedhimisht, kërkesat e paraqitësit të kërkesës bien jashtë juridiksionit të Komisionit prandaj edhe hedhen poshtë”.

Vendimi i është dorëzuar paraqitësit të kërkesës me 20 qershor 2011. Me 19 korrik 2011, paraqitësi (më tutje në tekst: “pala ankuese”) ka paraqitur një ankesë në Gjykatën Supreme, duke kundërshtuar vendimin e KKPK-së mbi bazën e vërtetimit jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të së drejtës materiale.

Pala ankuese ka deklaruar se KKPK-ja e kishte cituar në mënyrë të pasaktë deklaratën e tij. Ai ka deklaruar se asnjëherë nuk kishte pohuar se e kishte humbur pronën gjatë konfliktit në Kosovë në vitin 1998 dhe 1999, dhe se ai asnjëherë nuk kishte pohuar se familja e tij nuk kishte qenë në posedim të pronës që nga viti 1970. Pala ankuese ka konfirmuar se ai dhe familja e tij kishin qenë pronarë të pronës për 80 vite. Ai gjithashtu ka

potencuar se pala përgjegjëse në ankesë nuk kishte ofruar ndonjë provë të vlefshme se pronë ishte shitur ndonjëherë nga nëna e palës ankuese dhe ka theksuar se pronë është uzurpuar që 12 vite.

Pala ankuese kërkon që ankesa të zgjidhet në favor të tij dhe të prishte vendimi i KKPK-së.

Ankesa i është dorëzuar palës përgjegjëse në kërkesë (më tutje në tekst: “pala përgjegjëse në ankesë”) me 9 gusht 2011. Pala përgjegjëse në ankesë nuk ka reagu.

Gjykata Supreme i ka bashkuar kërkesat.

Arsyetim ligjor:

Ankesa është e pranueshme. Ajo është paraqitur brenda afatit prej 30 ditëve të paraparë në nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079.

Megjithatë, ankesa është e pabazuar. Vendimi i KKPK-së është i drejtë dhe gjykata nuk gjen as vërtetimin jo të plotë të gjendjes faktike dhe as zbatimin e gabuar të së drejtës materiale. Lëndët nuk janë në juridiksion të KKPK-së.

Gjykata dëshiron të theksojë se KKPK-ja nuk e ka cituar në mënyrë të pasaktë palën ankuese. Në dy nga kërkesat e tij, pala ankuese kishte nënshkruar një formular me të cilën ai konfirmonte se e kishte humbur pronën si pasojë e konfliktit të vitit 1998/1999 dhe si datë të humbjes e kishte cekur 01/01/1999. Megjithatë, deklarata e paraqitësit të kërkesës se kishte shkuar në Prokuplje qysh në vitin 1962 nënkupton se ai nuk ka qenë në posedim të pronës që nga ajo kohë. Prandaj, gjykata nuk gjen ndonjë vërtetim të gabuar të fakteve nga ana e KKPK-së.

Gjykata pajtohet me KKPK-së se lëndët nuk janë në kuadër të juridiksionit të KKPK-së.

Sipas nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, paraqitësi i kërkesës ka të drejtë në një urdhër nga Komisioni për ri-posedim të pronës nëse paraqitësi i kërkesës jo vetëm që dëshmon pronësinë e pronës së paluajtshme private, por edhe që ai apo ajo nuk është në gjendje t'i ushtrojë këto të drejta pronësore për shkak të rrethanave që ndërlidhen drejtpërsëdrejti apo rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë ndërmjet 27 shkurti 1998 dhe 20 qershorit 1999.

Megjithatë, paraqitësi i kërkesës në këtë rast nuk ka vërtetuar se është i kufizuar në ushtrimin e të drejtave të kërkuara pronësore për shkak të konfliktit të armatosur të vitit 1998/1999. Pala ankuese nuk pohon se ai apo nëna e tij është dashur të largohen nga prona për shkak të konfliktit të armatosur. Sipas arsytimit në ankesën e tij, ai vetë ishte vendosur në Prokuplje qysh në vitin 1962. Megjithatë, pala ankuese deklaroi se nëna e tij, bartësja e së drejtës pronësore, “kishte jetuar në tokën” e cila gjendet në Komunën e Podujevës deri në vdekjen e saj në vitin 1983. Megjithatë, kjo deklaratë bie ndesh me certifikatën e vdekjes të paraqitur nga paraqitësi i kërkesës e po ashtu edhe me deklaratën e tij të dhënë me 13 janar 2011. Certifikata e vdekjes tregon se nëna e tij ishte larguar nga Podujeva në vitin 1981. Prandaj, faktet e dhëna nga paraqitësi i kërkesës në ankesën e tij duken me tepër së të kontestueshme. Paraqitësi i kërkesës gjithashtu nuk deklaroi se kishte bërë përpjekje për të marrë posedimin e pronës në çfarëdo mënyre pas vdekjes së nënës së tij.

Prandaj, nuk ka ndonjë shenjë apo madje ndonjë provë se paraqitësi i kërkesës e kishte humbur pronën si rezultat i konfliktit të armatosur në Kosovë në vitin 1998/1999. Përkundrazi, faktet e dhëna nga paraqitësi i kërkesës në ankesën e tij dhe mbi të gjitha në deklaratën e tij të datës 13 janar 2011 japin arsye për të besuar se prona ishte humbur (në çfarëdo mënyrë) qysh para se të vdiste nëna e paraqitësit të kërkesës në vitin 1983. Pala ankuese në deklaratën e tij thekson: “Nëna ime e ndjerë kishte qenë për çdo ditë nën presione dhe shantazhe nga familja S. për t’ua shitur pronën në fshat. Megjithatë, ajo nuk kishte dashur ta shiste pronën dhe kishte mbetur aty, ndërsa pak para vdekjes së saj ajo kishte ardhur për të jetuar me mua në Prokuplje”. Kjo deklaratë tregon se qysh në vitet 1980-ta kishte pasur vështirësi e madje edhe para kësaj. Duke marrë parasysh faktin se pala ankuese në dy nga formularët e kërkesave kishte dhënë datën “01/01/1981” si datë të humbjes, gjykata pretendon se humbja e tërë pronës kishte ndodhur shumë kohë para konfliktit të vitit 1998/1999. Sidoqoftë, pala ankuese nuk ka dhënë fakte të mjaftueshme për të dëshmuar se prona ishte humbur për shkak të rrethana që ndërliken drejtpërsëdrejti me konfliktin e armatosur në vitin 1998/1999.

Prandaj, pasi që kërkesa është jashtë juridiksionit të KKPK-së, KKPK-ja nuk ka vendosur rreth pronësisë së palës ankuese dhe në këtë mënyrë KKPK-ja nuk ka pasur nevojë të hetojë me tej këtë çështje.

Për shkak të mungesës së juridiksionit, gjykata nuk ka vendosur nëse pala ankuese është ose jo pronar i pronave të kërkuara. Prandaj, vendimi i kësaj gjykate nuk paragjykon vendimin e një gjykate kompetente..

Shpenzimet e procedurës:

Në bazë të Shtojcës III, nenit 8.4 të Urdhresës Administrativ (UA) 2007/5 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, palët lirohen nga shpenzimet e procedurës para Sekretarisë Ekzekutive dhe Komisionit. Megjithatë, një

përrjashtim i tillë nuk është i paraparë për procedurat para Kolegjit të Apelit. Si pasojë, regjimi normal i pagesës së taksës gjyqësore të paraparë më Ligjin mbi Taksat Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e KSAK-së, 3 tetor 1987) dhe me UA nr. 2008/2 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi unifikimin e taksave gjyqësore për procedurat para Kolegjit të Apelit.

Kështu që, tarifatat e mëposhtme të gjykatës zbatohen për procedurat aktuale të apelit::

- Taksa nga tarifa gjyqësore për paraqitjen e ankesës (neni 10,11 i UA 2008/2): 30 €
- Taksa nga tarifa gjyqësore për nxjerrjen e aktgjykimit (nenet 10,21, 10,12 dhe 10.1 të UA 2008/2), duke pasur parasysh se vlera e pronës së kërkuar më arsye mund të vlerësohet në € 50,000: € 300 (€ 50 + 0,5% e € 50,000).

Këto taksa nga tarifa gjyqësore duhet të merren përsipër nga ankuesi që humb rastin. Në përputhje me nenin 46 të Ligjit mbi Shpenzimet Gjyqësore, afati për pagesën e taksave në fjalë nga personi i cili ka vendqëndrim ose vendbanim jashtë vendit nuk mund të jetë më i shkurtër se 30 ditë e më i gjatë se 90 ditë. Gjykata Supreme vendos që në rastin konkret, shpenzimet gjyqësore duhet të paguhen nga ankuesi në afat prej 90 ditësh nga dita kur aktgjykimi i është dorëzuar atij. Neni 47.3 parasheh që në rast se pala nuk i paguan taksat brenda afatit të dhënë, pala duhet të paguajë një gjobë prej 50% të shumës së gjobës. Në rast se pala nuk i paguan taksat brenda afatit të dhënë, atëherë bëhet zbatimi i detyrueshëm i pagesës.

Këshillë juridike

Në përputhje me Nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, EULEX

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Elka Ermenkova, Gjyqtare e EULEX-it

Urs Nufer, Referent i EULEX-it

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-100/11

Prishtinë, 18 Prill 2012

Në çështjen ligjore të:

V.A.G.

Paraqitësi i kërkesës/Ankuesi

Kundër.

N.F.

Pala përgjegjëse në kërkesë/Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, Elka Ermenkova dhe Sylejman Nuredini, Gjyqtarë, pas shqyrtimit të mbajtur me 18 Prill 2012, mori këtë

AKTVENDIM

Pjesa hyrëse e aktgjykimit të datës 8 Mars 2012 (GSK-KPA-A-100/11) është ndryshuar për shkak të mungesave në lidhje me formën e shkruar të aktgjykimit (Neni 165.1 LPK-ës) dhe përmirësohet si vijon:

V.A.G.

Paraqitësi i kërkesës/Ankuesi

kundër.

1. N.F.

2. R.F.

3. I.F.

4. E.F.

Palët përgjegjëse në kërkesë/Palët përgjegjëse në ankesë

Anne Kerber, Gjyqtare Kryesuese e EULEX-it

Sylejman Nuredini, Gjyqtarë

Elka Ermenkova, Gjyqtare e EULEX-it

Urs Nufer, Rexhistrues i EULEX-it